



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.182 dt.15.12.1997

**“CELJE FONDI PER NDERMARRJEN PERPUNIM PLEHUT  
PER VITIN 1998”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.15.12.1997, pasi shqyrtoi dhe miratoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës, bazuar në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

**VENDOSI**

1. Çeljen e një fondi për shpenzimet operative për traktorin privat, i cili bën grumbullimin, spostimin e mbeturinave në fushën e Sharrës. Ndërmarrjes Përpunim Plehut për vitin 1998 i miratohet fondi prej 2.059.2 mijë lekë, mbi bazën e të cilit të bëhet prokurimi për marrjen me qira të një traktori.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi me 01.01.1998.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**

